



Java e Kuzhinës Italiane në Botë Kosovë, 13-19 nëntor 2023

Ambasada e Italisë në Prishtinë, në bashkëpunim me Italian Trade Agency (ITA) dhe Institutin Italian të Kulturës, janë krenarë të lançojnë Edicionin VIII të Javës së Kuzhinës Italiane në Kosovë, e cila do të mbahet nga 13 deri më 19 nëntor 2023. Eventit me tematikë dedikuar promovimit të kuzhinës italiane dhe produkteve agrourbushqimore përfshin një sërë aktivitetesh të cilat i drejtohen profesionistëve në këtë sektor si GDO, sektori Ho.Re.Ca, insitutet e kulinarisë dhe shkollat hoteleri-turizëm, gazetarë dhe institucione të sektorit.

Në tavolië me kuzhinën italiane: mirëqënia me shije, kjo është tema e vitit 2023. Kosova merr pjesë në Javën e Kuzhinës Italiane me nisma të fokusuara në promovimin e përsosmërisë së gastronomisë Made in Italy dhe Italian Lifestyle.

Në kuadër të këtij projekti ITA do të organizojë më 16 nëntor në Prishtinë një **Degustim** të produkteve tipike si pica dhe vera, pranë Antica Pizzeria da Michele, me qëllim promovimin e kuzhinës tradicionale italiane pranë operatorëve vendas. Nisma realizohet në bashkëpunim me Shoqatën Italiane të Sommelierëve (AIS).

Ambasada në Prishtinë dhe ITA kanë përfshirë gjithashtu dhe 11 restorante në Prishtinë dhe qytete të tjera të Kosovës, të cilat do të ofrojnë një menu speciale italiane me koston simbolike prej 10 euro gjatë Javës së Kuzhinës Italiane në Kosovë.

Për më shumë informacion na ndiqni në rrjetet tona sociale:

Facebook: <https://www.facebook.com/iceagenziaalbania/>

Twitter: <https://twitter.com/itatirana>

Instagram: https://www.instagram.com/itatradeagency_tirana/

Web site: <https://italiantastekosovo.com/>

